

**16 maj 2006**

## **Komunikatë për media**

### **Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall Valën e 26-të të Privatizimit**

**PRISHTINË** – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) të martën me 16 maj, 2007 zyrtarisht shpalli valën e 26-të të Privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH). Menjëherë pas mbledhjes së Bordit të mbajtur më 3 maj, AKM-ja ka njoftuar menaxhmentin e NSH-ve dhe Komunitat përkatëse për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve, ndërsa sot i ka postuar njoftimet për tender në faqen e AKM-së në internet, [www.kta-kosovo.org](http://www.kta-kosovo.org)

Në listën e tenderëve të privatizimit të valës 26 janë përfshirë 13 Ndërmarrje Shoqërore nga të cilat janë krijuar 18 Ndërmarrje të Reja.

12 Ndërmarrje Shoqërore do të privatizohen përmes spinof-it të rregullt, ku do të krijohen 17 Ndërmarrje të Reja.

1 Ndërmarrje Shoqërore do të tenderohet përmes spinof-it special, ku do të krijohet 1 Ndërmarrje e Re.

**Afati për parakualifikim është deri në ditën e mërkurë, 11 korrik 2007.**

**Data për dorëzimin e ofertave është dita e mërkurë, 18 korrik 2007.**

\*\*\*\*\*

Bashkangjitur në këtë komunikatë për media mund të gjeni listën e plotë të ndërmarrjeve:

**Ndërmarrja e Re Depo dhe Toka Bujqësore në Gërmovë Sh.P.K.** - prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore dhe depoja që gjendet në afërsi të fshatit Gërmovë, në afërsi të rrugës kryesore Viti – Gërlicë në Komunën e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 57.5 hektarësh. Pjesa më e madhe e tokës është përdorur për kultivimin grurit dhe drithërave. Sidoqoftë shumica e tokës nuk është kultivuar rregullisht në vitet e fundit.

**Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore në Nec Sh.P.K.** - prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në afërsi të fshatit Sllatinë, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 85 hektarësh. Pjesa më e madhe e tokës është përdorur për kultivimin grurit dhe drithërave. Sidoqoftë shumica e tokës nuk është kultivuar rregullisht në vitet e fundit.

**Ndërmarrja e Re Toka bujqësore në Pozharan-Stub Sh.P.K.** - prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në mes të fshatrave Gërmovë dhe Pozharan, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 23 hektarësh. Pjesa më e madhe ë tokës është përdorur për kultivimin grurit dhe drithërave. Sidoqoftë shumica e tokës nuk është kultivuar rregullisht në vitet e fundit.

**Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Beli Dub Sh.P.K.** - prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga toka bujqësore që gjendet në afërsi të fshatit Goshicë, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 62 hektarësh. Pjesa më e madhe ë tokës është përdorur për kultivimin grurit dhe drithërave. Sidoqoftë shumica e tokës nuk është kultivuar rregullisht në vitet e fundit.

**Ndërmarrja e Re Depo në Pozharan Sh.P.K.** - prona kryesore e kësaj Ndërmarrjeje të Re përbëhet nga zyra administrative, depo dhe oborri që gjendet në fshatin Pozharan, Komuna e Vitisë. Prona e përgjithshme që do t'i bartet Ndërmarrjes së Re ka një sipërfaqe të përafërt prej 2 hektarësh. Depoja është përdorur për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore. Sidoqoftë viteve të fundit nuk është përdorur për këtë qëllim.

**Ndërmarrja e Re Pasuria Bujqësore depo Sh.P.K.** - ky tender ofron mundësin e blerjes së një ndërtese një-katëshe me 45 ari tokë, e që për momentin shfrytëzohet për qëllime industriale dhe ndodhet përballë Fabrikës së Gypave dhe afër udhëkryqit të rrugëve të Reçakut dhe Cen Dugolli në Ferizaj.

**Ndërmarrja e Re Agro-kultura Fabrika për Përpunimin e Mishit Sh.P.K.** - tenderi i jep mundësi investitorit të marrë fabrikën për përpunimin e mishit në të vendosur në fshatin Velekincë (komuna e Gjilanit). Me blerjen e kësaj Ndërmarrjeje të Re do t'i hapet qasja në tregun Kosovar të ushqimit dhe do t'i lejohet mundësia e zgjerimit. Prona që është lëndë e këtij tenderi ka një sipërfaqe toke prej përafërsisht 58,180m<sup>2</sup> (05.81.80 ha). Ndërtesat kryesore përfshijnë përafërsisht sipërfaqen prej 10,027 m<sup>2</sup> dhe hapësirën e hapur - oborrin sipërfaqe të përafërt prej 48,153 m<sup>2</sup> në kuadër të kompleksit të fabrikës për përpunimin e mishit.

**Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Rakosh Sh.P.K.** - i ofron investitorit tokë të pjellshme bujqësore me sipërfaqe prej afro 75 ha dhe ndërtesa administrative. Ndër. e Re gjendet afër Istogut.

**Ndërmarrja e Re Dubrava Sh.P.K.** - me rreth 300 ha tokë bujqësore (me ferma me hangar dhe ndërtesa). Shtirihet në zonat kadastrale Dubravë, Shushice. Toka bujqësore është ngjitas për fermën me hangar dhe ka sistem të ujitjes.

**Ndërmarrja e Re Drelaj Sh.P.K.** - subsidiarja sherben si pikë mbledhëse e frutave malore të ndryshëm e sidomos për boronica, gjithashtu dhe produkteve qumështor si djathit dhe mazës. E vendosur në një lokacion atraktiv të Grykës së Rugovës. Ndërmarrja e Re përfshin objektin e ri të ndërtuar nga tullat dhe betoni me përafërsisht 345 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës është përafërsisht 42 ari e ndarë në tri parcela. Duhet të kini parasysh se nuk ka asete lëvizëse.

**Ndërmarrja e Re Toka Bujqësore Drenovc Sh.P.K.** - i ofron investitorit potencial të blejë tokë bujqësore me sipërfaqe prej 240 ha në fshatin Drenovc në rrugën kryesore Pejë-Prishtinë.

**Ndërmarrja e Re Ndërtimtari Sh.P.K.** - ofron rast unik për të marrë sipërfaqe përafërsisht 1.19 ha tokë në Zonën Industriale, një zonë ku kohëve të fundit janë zhvilluar shumë biznese. Ndërmarrja ka një sipërfaqe prej 676m<sup>2</sup> depo.

**Ndërmarrja e Re NBI Suhareka Prona e Fermës së dhive Sh.P.K.** - përfshin një sipërfaqe të përafërt rreth 50 Ha (livadhe dhe tokë të punueshme) e cila gjendet në afërsi të fshatrave Sallagrazhde dhe Grejkoc si dhe një numër të ndërtesave (montazh) me një sipërfaqe totale prej afërsisht 5,000 m<sup>2</sup>.

**Ndërmarrja e Re Komuna Klinë – Njësia prodhuese Sh.P.K.** - prona e ndërmarrjes për tu bartur në subjektin e ri përmban njësinë prodhuese që ndodhet afër hekurudhës në Klinë dhe përmban një sipërfaqe prej përafërsisht 1,72,02 ha.

**Ndërmarrja e Re Podrima Rahovec – Shitoret në Qendër Sh.P.K.** - gjendet në qendër të qytetit të Rahovecit dhe përfshin një Kompleks të Shitoreve.

Kjo Ndërmarrje Subsidiare përfshin 5 shitore në Rahovec me një sipërfaqe të përgjithshme prej përafërsisht 368.8 m<sup>2</sup>.

Podrima është një prej kompanive kryesore për tregti dhe shitje me pakicë në Regjionin e Prizrenit që gjendet në qytetin e Rahovecit dhe fshatrat përreth.

**Ndërmarrja e Re Kooperimi Agro-qendra në Suharekë Sh.P.K.** - përfshin një sipërfaqe të përafërt me 0,26,42 ha (2,642 m<sup>2</sup>). Ndërtesa e Agro-qendrës e cila do të bartet në Ndërmarrje të Re përmban zyre me një hapësirë të përafërt me 430 m<sup>2</sup> si dhe pompën për derivate (naftë) me një rezervar me kapacitet prej 25 tonëve.

**Ndërmarrja e Re “Kosovatrans – Baza e Riparimit Teknik & Autobusët – Prizren” Sh.P.K.** –

Kosovatransi është një prej kompanive kryesore të transportit të udhëtarëve në Kosovë, e cila gjendet në Regjionin Jugperëndimor të Kosovës.

Propozimi për këtë Ndërmarrje do të bëhet përmes shitjes me Spin-off të rregullt dhe do t'i përfshij Autobusët e Stacionit të Autobusëve në Prizren (14 Autobusë, 7 prej të cilëve janë në gjendje pune dhe 7 janë në defekt) dhe Bazën e Riparimit Teknik (Njësi e Ndërmarrjes) e cila gjendet në Prizren me një sipërfaqe të përgjithshme prej 69 ari dhe 92 m<sup>2</sup>.

Me një investim të duhur në Autobusë dhe pajisje tjera, do të ketë mundësi të zgjerojë biznesin dhe të konkurroj me kompanitë private të transportit veçanërisht në lëmin e transportit të udhëtarëve.

**Ndërmarrja e Re e mëposhtme është në dispozicion përmes Spin-off-it Special:**

**Ndërmarrja e Re Industria Ushqimore Prizren Sh.P.K.** - "Industria Ushqimore" Prizren, gjithashtu e njohur si "Progress Cannery" (Fabrika e Konservimit Progresi) është ndërmarrje për përpunimin e pemëve dhe perimeve e cila, në këtë kohë, i nënshtrohet lejes për operim e cila do të mbaroj me privatizimin. Linjat e ndërmarrjes për përpunime përfshijnë specat, fasule, tranguj, keçap, marmelata etj. Ka linja për paketim që përdorin xhamin (qelqin), ambalazh metalik dhe plastik dhe ambalazhim të ushqimeve të ngjira. E vendosur në 8.76 ha., ndërmarrja gjithashtu përfshinë ndërtesën e administratës, frigoriferët dhe depot.